

## AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “V-Z-P ” Shpk

Une, Petrit Zoga i datelindjes 12.08.1962 , banues ne adresen : Tirane ,Kavaje .Rruga “Skenderbeu”, identifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr .BD3344323 , me nr.peronal G20812023P , qe ne vijim do te quhet “**Ortak**”

Sot me date 19/02/2024, vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**V-Z-P ” Shpk**, ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

#### Kreu I

#### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

#### **Neni 1.Objekti I shoqerise**

**1.1 Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:** Ndertim objektesh, civile dhe ekonomike. Rikonstruksion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash. ura, prita, ujesjellesa, kanalizime, punime mbrojtje etj. Prodhim guresh dekorativ dhe inerte. Pastrim dhe gjelberim i hapësirave publike. Rehabilitim i objekteve pas shfrytezimit. Instalime elektrike dhe hidraulike. Ndertim dhe mirembajtje rruge dhe kanalizime. Materiale ndertimi, punime ndertimi, hoteleri, turizem. Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulmeve. Punime dhe sherbime te tjera te

specializuara ne ndertim suvatime dhe monetime dyer, dritare, shkalle etj si dhe kryerja e aktiviteteve te tjera te ngjashme me to. Punime dheu, sistemim tarracash te terreneve. Prodhim i elementeve te paranderur dhe armocementit. Tregti paisjesh te ndryshme, material ndertimi dhe mallrash te importit- eksport me shumice dhe pakice etj

**1.2.** Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

## **Neni 2.** Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

**2.1.** Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertojne

**“ V-Z-P ” Shpk**

**2.2.** Selia e Shoqerise ndodhet ne: Tirane ,Kavaje ,Golem Rruga “Skenderbeu” Zona kadastrale 1791,N.pasurie 101/101+1-1,Ndertese kati pare

**2.3.** Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni.3. Regjimi Juridik**

**3.1.** Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

**3.2.** Me vendim te Ortakut te vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

**3.3.** Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

**3.4.** Shoqeria do te kete vulen e saj

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

**4.1.** Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

**4.2.** Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

**4.3.** Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndtyshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

**4.4.** Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

**4.5.** Ortaku i vetem ka te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

**4.6.** Ortaku i vetem ka te drejte te beje propozime, si dhe emerone e shkarkojne, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likujdatoret



## **Neni 5**

### **Kohezgjatja**

**5.1.** Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

## ***Kreu III***

### ***KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT***

## **Neni 6**

**1.** Kapitali themeltar eshte **100.000** (njqind mije) leke dhe eshte i ndare ne **1** kuote me vlere nominale **100.000 leke**

**6.2.** Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte: .

Petrit Zoga 1 kuote, **perkatesisht 100% te kuotave**

## ***Kreu IV***

### ***ORGANET E SHOQERISE***


## **Neni 7**

**7.1.** Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaku I vetem ne Asamblene e Pergjithshme.Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise.Administratori i Shoqerise dhe eksperti kontabel I autorizuar caktohen nga Ortaku I vetem i shoqerise

## ***Kreu V***

### ***ADMINISTRIMI***

## **Neni 8**



**8.1.** Administrimi I shoqerise do te behet nga z. Petrit Zoga

**8.2.** Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 ( pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit

## ***Kreu VI***

### ***DISPOZITA TE TJERA***

#### **Neni 9**

**9.1.** Fitimi I realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet ortakut te vetem te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

**9.2** Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete mane vendim nga asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave

**9.3.** Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

**“V-Z-P ” Shpk**

Petrit Zoga

